REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

P. 33/1
Df. 16.01.2020

# Vendim

**Nr. 9 datë 16.01.2020**

## Për propozimin për çmimin *Nobel* në letërsi të kandidaturës së akademikut Ismail Kadare

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë* si dhe në përgjigje të ftesës së Akademisë Mbretërore të Shkencave të Suedisë për të propozuar personalitete konkurues për çmimin *Nobel* në letërsi, Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës 16.01.2020,

Vendosi

1. T'i ripropozojë për nominim për çmimin *Nobel* në letërsi (2020) Akademisë Mbretërore të Shkencave të Suedisë kandidaturën e akademikut Ismail Kadare, anëtar i Asamblesë së ASHSH, personalitet shqiptar, europian dhe botëror në letërsi dhe në lëvizjen e mendimit.

2. Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike të përgatisë *letrën e motivimit* me të dhëna e vlerësime të përditësuara; *bibliografinë e aktualizuar të veprimtarisë krijuese të shkrimtarit* dhe të studimeve kushtuar veprës së tij brenda dhe jashtë vendit, si dhe *profilin intelektual* të tij, të plotësuar.

3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të ASHSH dhe hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

AKADEMIK SKËNDER GJINUSHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AKADEMIA E SHKENCAVE